



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

PROJEKTLIGJ

Nr. _____, 2019

PËR

**NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 9900, DATË 10.04.2008 “PËR REZERVAT
MATERIALE TË SHTETIT”**

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Në ligjin nr. 9900, datë 10.04.2008 “Për rezervat materiale të shtetit” bëhet ky ndryshim:

Neni 1

Pika 1, e nenit 10, “Lëvrimi”, ndryshohet, si vijon:

“1. Lëvrimi dhe shitja e mallrave rezervë të grupit A bëhet me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit.”

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.